



Pranuar / Dorezuar Primiten/Protolato Received/Delivery	21.04	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojci e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	2310/2022		1/7	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.215/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.215/2022 të datës 08.03.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi:

me adresë banimi: [redacted] në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 21.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.215/2022 e datës 08.03.2022, e parashtruar nga ankuesja
- II. NDRYSHOHET Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2021 i datës 05.02.2022 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesen nga nota (3.01) në notën e përgjithshme mirë (3.62) si dhe notën për objektivin numër:3 nga nota (2) në notën (3).
- III. Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë si në pikën II të dispozitivit dhe i njëjti të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunëses civile.
- IV. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesja, [redacted] sipas shkresave të lëndës e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, e pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 më datë 08.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës kundër Formularit për Vlerësimin e Punës për vitin 2021 të datës 05.02.2022 e pranuar nga ankuesja me datë 07.02.2022 me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike sa i përket objektivit numër:3 dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 11.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 18.03.2022 ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë, sikurse edhe e-mailin njoftues me dokumente përcjellëse shtesë të datës 18.03.2022 i protokolluar në Këshill me numër:1454/2022 i datës 21.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 08.03.2022 me Nr.Prot:1226/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 08.03.2022 dërguar nga ankuesja në Këshill; E-mailin e datës 03.02.2022 dërguar nga ankuesja për [redacted] me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mailin e datës 07.2.2022 dërguar nga SIMBNJ për ankuesen; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 05.02.2022; Raportin mbi mbikëqyrjen e ekonomike i datës 17.08.2021 si dhe tabelat e bashkangjitura prej tre (3) faqesh; Shkresën e datës 16.07.2021 dërguar nga CEO i Limak Kosovo International Airport JSC me numër prot:5472/2021; Shkresën e titulluar: Operating and financial Report Quarter II, prill 2021 i datës 15.07.2021; E-mailin e datës 05.03.2021 dërguar nga Omer Kuyucu për [redacted] Padinë e datës 19.02.2021 ushruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative nga Limak Kosovo International Airport JSC kundër të paditurës në Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës; Shkresën e datës 19.02.2021 lëshuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës; Emailin e datës 09.06.2021 dërguar nga ankuesja për [redacted] me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mailin e datës 06.08.2021 dërguar nga ankuesja për [redacted] me korrespondencën e bashkangjiture prej tre (3) faqesh; Vendimin e datës 12.11.2021 të Komisionit për shqyrtimin e shkelleve administrative i ACC-së; E-mailin e datës 09.08.2021 dërguar nga ankuesja për [redacted] E-mailin me shkresën e ankueses të datës 04.04.2021 dërguar në Këshill me provat e bashkangjitura shtesë; Raportin vjetor të Autoritet të Aviacionit Civil të Kosovës i vitit 2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.03.2022 me numër prot:1306/2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 18.03.2022 me numër protokoll 1444/2022; Akt emërimit e ankueses të datës 01.01.2012 me formularin e përsëkrimit të detyrave të punës 13.06.2017; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 30.01.2020; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 23.04.2021; E-mailin e datës 24.01.2022 dërguar nga [redacted] për [redacted] Raportin e vijueshmërisë në punë për ankuesen; Vërejtjen e datës 01.07.2021; Vërejtjen e datës 31.03.2021; Rregulloren Nr.04/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në Tokë, Rregullore 05/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores 04/2011; E-mailin e datës 21.01.2021 dërguar nga [redacted] për [redacted] E-mailin e datës 21.01.2021 dërguar nga [redacted] për ankuesen me korrespondencën e e-maileve të bashkangjitur prej tre (3) faqesh; E-mailin e

datës 29.03.2021 dërguar nga [redacted] për ankuesen me korrespondencën e e-maileve të bashkangjitur prej shtatë (7) faqesh; E-mailin e datës 25.03.2021 dërguar nga [redacted] për [redacted] me korrespondencën e e-maileve të bashkangjitur prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 20.01.2021 dërguar nga [redacted] për ankuesen me korrespondencën e e-maileve të bashkangjitur prej tre (3) faqesh; E-mailin e datës 01.07.2021 dërguar nga [redacted] për ankuesen me korrespondencën e e-maileve të bashkangjitur prej pesë (5) faqesh.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuses [redacted], është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 01.01.2012 mbanë pozitën "Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit" në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa në bazë të formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 me datë 05.02.2022 nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është vlerësuar me notë të përgjithshme tre pikë një (3.1), ndërsa për objektivin i identifikuar me numër:3 si në formular është vlerësuar me notë dy (2).

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe besueshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuses se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 nga Udhëheqësi i saj i Drejtpërdrejtë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, në kërkesën për përgjigje në ankesë e protokolluar me numër:1306/2022 të datës 11.03.2022, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ndër të tjera, ka kërkuar: "Shkresën me përcaktimin e Objektivave të punës për ankuesen gjatë vitit 2021; si dhe Dëshmi se ankuesja ka proceduar raportet ndërlidhur me objektivat e punës tek Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë", ndërsa Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës përmes shkresës së datës 18.03.2022 të nënshkruar nga udhëheqësi i ankuses, njëherit Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore kanë kthyer përgjigje, mirëpo nuk kanë arritur të dëshmojnë me fakte se cilat kanë qenë realisht objektivat punës së ankuses për vitin 2021 për të cilat janë pajtuar ankuesja me udhëheqësin e saj siç përcaktohet me nenin 6 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: "1. Brenda muajit Janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet; 3.Objektivat dhe plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave përcaktohen me shkrim sipas afateve në paragrafin 1 të këtij neni dhe vendosen në formularin e vlerësimit (Formularin 1) si dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin vjetor të nëpunësit. Formularin 1 është shtojcë dhe pjesë përbërëse e kësaj Rregullore. 4. Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit".

Po ashtu, Kolegji me përgjigjen e datës 18.03.2022 e protokolluar me numër 1444/2022 dërguar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës si dhe shkresës përcjellëse përmes e-malit të datës 18.03.2022 nuk ka pranuar fakte të provueshme se ankuesja ka raportuar gjatë vitit kalendarik 2021 tek udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë, mirëpo ankuesja me rastin e parashtrimin të ankesës në Këshill, ka pretenduar se e njëjta lidhur me realizmin e objektivit i identifikuar me numër:3-Mbikëqyrja ekonomike e ofruesve të shërbimeve në tokë, te udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë i ka përcjellë:

Raportin e Mbikëqyrjes vjetore ekonomike të Ex-Fis për vitin 2020 e nr. Ref BNRREA/4/1 të datës 28.06.2021; Raportin e Mbikëqyrjes vjetore ekonomike të LKIA-së për vitin 2020 me numër ref BNRREA/1/4/ të datës 16.07.2021; Raportin e Mbikëqyrjes së jashtëzakonshme ekonomike të LKIA-së për TM1 për vitin 2021 me nr RefBNRREA/4/1/ të datës 27.04.2021; Raportin e Mbikëqyrjes së jashtëzakonshme ekonomike të Ex-Fis për TM1 për vitin 2021 me nr refBNRREA/4/1 të datës 17.05.2021; Raportin e Mbikëqyrjes së jashtëzakonshme ekonomike të LKIA-së për TM2 për vitin 2021 me nr RefBNRREA/4/1/ të datës 17.08.2021 si dhe Raportin e Mbikëqyrjes së jashtëzakonshme ekonomike të LKIA-së për TM3 për vitin 2021 me nr RefBNRREA/4/1/ të datës 08.11.2021 ndërsa ka bashkangjitur në cilësi të provave raportin e specifikuar si më lartë si dhe Vendimin nr.01/ZDP/VE/2021 të datës 19.01.2021, raportimin e datës 09.06.2021 nga BU të DP, raportin e datës 06.08.2021 nga BU për DP, Vendimin me numër prot2021/KSHSHA/323, komunikimet me e-mail nga ankuesja tek Drejtori i Përgjithshëm të datës 09.08.2021, ndërsa pavarësisht që Këshilli me rastin e dërgimit të përgjegjës në ankesë të datës 11.09.2022 e ka bashkangjitur edhe ankesën e ankueses dhe institucioni ka pasur mundësinë të analizojë pretendimet e palës ankuese si dhe të ofrojë prova që kundërshtojnë pretendimet e saj ankimore, të njëjtit nuk kanë vepruar në pajtim me nenin 7 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *"Me qëllim të ushtrimit të funksioneve, Këshilli ka të drejtë të: kërkon dhe merr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij"*, andaj provat e paraqitura nga ankuese janë pranuar si të mirëqena.

Kolegji me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankueses Kolegji ka pasur parasysh e-mailet e bashkangjitura të dërguara në cilësi të provave nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, respektivisht tërheqjet e vërejtjes apo sygjerimit të Drejtorit të Përgjithshëm dërguar ankueses në periudhën kohore nga data 21.01.2021 deri me datë 29.03.2021 e që kryesisht kanë të bëjnë lidhur me arritjen e objektivit të përcaktuar me numër: 3- Mbikëqyrja ekonomike e ofruesve të shërbimeve në tokë, ndërsa po ashtu ka pasur parasysh pretendimet e palës ankuese se Vendimi nr.01/ZDP/VE/2021 i dhe datës 19.01.2021 i cili është nxjerrë me qëllim që të detyronte operatorin të zbatojë rregulloren, i cili në përmbajtjen e tij përcakton se zbatimi i këtij vendimi kërkon angazhimin e dy departamenteve teknike, atij të aerodromeve dhe të rregullimit ekonomik ndërsa në bazë të Akt -emërimit të datës 01.01.2012 Kolegji ka gjetur se ankuesja udhëheqë me Departamentin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullimin Ekonomik të Aviacionit, po ashtu ankuesja më datë 04.04.2022 ka bërë plotësimin e ankesës me pretendimin se e njëjta nuk është përgjegjësi për mos zbatimin e rregulloreve të ACC-së dhe vendimeve nga ana e operatorit LKIA (LIMAK) dhe provat e bashkangjitura shtesë sikurse Raportin Vjetor 2021 të Autoritetit të Aviacionit Civil i cili në pjesën e emërtuar 7.6 Bashkëpunimi Ndërinstitucional, pika C) Takimi me Departamentin Qendror për PPP-në në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, citoj: *"Me datën 11 mars 2021, Drejtori i Përgjithshëm, së bashku me bashkëpunëtorët priti në takim Drejtorin e Departamentit Qendror për PPP-në në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve së bashku me bashkëpunëtorët e tij. Në takim u diskutua rreth bashkëpunimit në mes të AAC dhe AQPPP-së, me theks të veçantë për padinë e operatorit LKIA (LIMAK) kundër Vendimit të lëshuar nga AAC-ja për hapjen e tregut të shërbimeve në tokë. AAC-ja ka njoftuar përmes shikresave Komitetin e PPP-së për refuzimin e LKIA-së për të zbatuar Rregulloren nr.04/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në Tokë si dhe Vendimin nr.01/ZDP/VE/2021 të datës AAC-së të datës 19 janar 2021, lidhur me lejimin e qasjes në treg për ofruesit e tjerë të shërbimeve në tokë"*, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se komenti i Drejtorit të Përgjithshëm lidhur me vlerësimin e ankueses me notën 2 për objektin e



përcaktuar me numër:3- Mbikëqyrja ekonomike e ofruesve të shërbimeve në tokë sipas formularit të vlerësimit të rezultateve në punë të datës 05.02.2022, me komentin: "Veprimet e juaja lidhur me implementimin e Rregullores 04/2021 nuk kanë qenë të pakënaqshme dhe shumë herë keni vepruar duke qenë në kundërshtim me vet rregulloren 04/2011 dhe vendimet e ACC.", janë në kundërthënie me përshkrimin e shkëputur dhe të cituar më lartë të Raportin Vjetor 2021 të Autoritetit të Aviacionit Civil, sikurse mbetet e pa qartë se për cilat vendime konkrete dhe rregullores 04/2021 e ka pasur fjalën Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, andaj pretendimi ankimor i ankueses se e njëjta e ka arritur objektivin i përcaktuar me numër:3-Mbikëqyrja ekonomike e ofruesve të shërbimeve në tokë është i bazuar ndërsa vlerësimi nga Drejtori i përgjithshëm sa i përket këtij objektivi është i paqëndrueshëm ngase vërehet qartë sikurse u specifikua edhe në pjesën e shkëputur nga Raportin Vjetor 2021 të Autoritetit të Aviacionit Civil zbatimi apo mos zbatimi i rregullores dhe vendimeve të Autoritetit të Aviacionit Civil nuk ka qenë në vullnetin e ankueses por të operatorit LKIA (LIMAK).

Kolegji lidhur me arsyeshmërinë e pretendimeve ankimore të ankueses se njëjta ka arritur objektivin e përcaktuar me numër:3 i cili është objekt shqyrtimi i kësaj ankese e ka pasur parasysh edhe nenin 43 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë ku përcaktohet se: "Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues", ndërsa dihet fakti se ankuesja me Vendimin e datës 02.11.2022 të Komisionit Disiplinor të AAC-së i është ndërprerë marrëdhënia e punës, ndërsa e njëjta është kthyer në punë duke shfuqizuar dhe anuluar vendimet e kontestuara nga ankuesja njëherit duke e aprovuar ankesën e ankueses përmes Vendimit A.nr.378/2020 i datës 24.12.2020 të Këshillit të pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, i cili sipas shkresës zyrtare është zbatuar nga Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me datë 13.01.2021 duke lënë të kuptohet se vendimi i Këshillit ishte i ligjshëm dhe i drejtë, kurse ankuesja për pjesën e parë të muajit janar 2021 ka qenë e larguar nga puna deri në momentin e zbatimit të vendimit të Këshillit.

Kolegji ka analizuar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të ankuese për vitin 2021 i datës 05.02.2022 Kolegji ka konstatuar se udhëheqësi i drejtpërdrejtë me rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen, respektivisht përcaktimit të notës mesatare nuk ka zbatuar udhëzimet e rregullores të përcaktuara si në nenin 10 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: "1. Vlerësimi për arritjen e objektivave të punës përbën 60% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, ndërsa vlerësimi i sjelljeve profesionale të nëpunësve civilë përbën 40% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit; 2. Nota mesatare e objektivave kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë objektivave të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e objektivave të vlerësuar; 3. Nota mesatare e sjelljeve profesionale (aftësive) kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë aftësive të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e aftësive të vlerësuar; 4. Nota e përgjithshme kalkulohet duke mbledhur 60% (shumëzuar me 60 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të objektivave dhe 40% (shumëzuar me 40 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të aftësive", ngase sipas vlerësimit me formulën e përcaktuar si më lartë nota e përgjithshme e vlerësimit del të jetë tre pikë pesë (3.5) e jo siç është vendosur tre pikë një (3.1), kalkulim ky i cili ankuesen e ka dëmtuar në kuptim të kategorizimit apo ndarjes dhe kuptimit të notave të vlerësimit sipas nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 si dhe paragrafit 2



nën paragrafit 2.2 i të njëjtit nen të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik.

Andaj, pas vlerësimit të provave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, pas analizimit të dispozitave ligjore në fuqi, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, si dhe në bazë të gjeturave të pasqyruara si më lartë në këtë vendim, Kolegji ka ardhur në përfundimin se ekziston baza e mjaftueshme ligjore sikurse edhe fakte dhe prova konkrete se ankuesja e ka arritur objektivin numër:3-Mbikëqyrja ekonomike e ofruesve të shërbimeve në tokë, ndërsa Kolegji vlerëson se të njëjtës në pajtim me nenin 13 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se: *"Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)"*, vendos t'i ndryshojë notën e vlerësimit për objektivin numër:3- Mbikëqyrja ekonomike e ofruesve të shërbimeve në tokë, nga nota dy (2) t'ia ngrisë në tre(3) ndërsa si rrjedhojë e ndryshon edhe notën e përgjithshme mesatare nga tre pikë një (3.1) në tre pikë gjashtëdhjetedy (3.62), e cila sipas përcaktimit të nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 si dhe paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 i të njëjtit nen të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: *"Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: nga 3.5 deri në pak se 4.5 nënkupton "shumë mirë"; dhe Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: "shumë mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit"*, nga rrjedh se pas ndryshimit të formularit të vlerësimit të rezultateve në punë i datës 05.02.2022 ankuesja vlerësohet përfundimisht me notë të përgjithshme tre pikë gjashtëdhjetedy (3.62) sikurse në sqarimet e dhëna në rregullore nënkupton *"shumë mirë"*.

Po ashtu, Njësia e Burimeve Njerëzore e Autoritetit të Aviacionit Civil duhet të kujdesët që vendimi i Këshillit të vendoset në dosjen personale të ankueses në pjesën ku mbahet regjistri i vlerësimeve të rezultateve në punë.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.215/2022

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.